



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më,10.04.2020 merr këtë

V E N D I M

PËR BARTJEN E BUXHETIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2019 NË VITIN 2020

I.

MIRATOHET Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2019 në vitin 2020.

II.

Shuma e mjeteve të bartura, si në pikën I të këtij vendimi, është **27,473,465.55 €**.

III.

Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, destinohet si në vijim:

1. *Subvencione dhe transfere*, shuma prej **2,390,000.00 €**;
2. *Investimet kapitale*, shuma prej **23,323,465.55 €**;
3. *Mallra dhe sherbime*, shuma prej **1,760,000.00 €**;

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-400/01-64476/20, më 14.04.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

A r s y e t i m

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësive dhe Ligjin mbi buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Nga viti 2019 në vitin 2020, barten mjetet në shumë prej **27,473,465.55 €**.

Ndryshimet dhe bartja e mjeteve, sipas fushave, nga viti 2019 në vitin 2020, është orientuar në këto kategori ekonomike:

- **Subvencione dhe transfere** - mjete në shumë prej **2,390,000.00 €**, ku 1,400,000.00 € orientohen për Pakon ekonomike për COVID-19.
- **Mallra dhe shërbime** - mjete në shumë prej **1,760,000.00 €**,
- **Investime kapitale** - mjete në shumë prej **23,323,465.55 €** të mbetura nga viti 2019. Detajet për këto projekte janë të paraqitura në tabelat përcjellëse.